



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 155/2025

Datë: 03 mars 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25, nenit 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2020 Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe nenit 5 të Rregullores Nr.05/2017 për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel, në takimin e mbajtur më datë 03 mars 2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 pika 3 e vendimit KPK/Nr.554/2023 i datës 27 korrik 2023 për Themelimin e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, ashtu që për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, në vend të anëtares znj. Bedrije Sylja Alshiqi caktohet anëtare znj. Sheribane Selimi Muçaj, andaj komisioni do të ketë këtë përbërje:
 - 1.1 Arijana Shajkovci, Anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës - Kryesuese;
 - 1.2 Ilirjana Çollaku Tafa, Prokurore në Prokurorinë Speciale - Anëtare;
 - 1.3 Sheribane Selimi Muçaj, Prokurore në Prokurorinë e Apelit - Anëtare.
2. Obligohen anëtarët e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t' i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.
3. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.